REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA LUSHNJE

Nr.3244/1 Prot.

Lushnje, më 20/10/2025

PROJEKT- VENDIM

NR. 94 DATË 20 / 10 /2025

"PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PA KUNDËRSHPËRBLIM FUSHËN SPORTIVE "LLAZAR LLUPO" KRUTJE,NJËSIA ADMINISTRATIVE KRUTJE PËR EKIPET SPORTIVE TË SHOQATËS SPORTIVE YLBERI 1994(FC EAGLES)".

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur, në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b", nenit 54 shkronja e/1 të Ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen vendore", i ndryshuar. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.9, datë 04.01.2012 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore,që transferohen në pronësi osë në përdorim të Komunës Krutje.Neni 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. **Ju:**

PROPOZOJMË

1. Miratimin për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim fushën sportive "Llazar Llupo" Krutje,Njësia Administrative Krutje nga ekipet sportive të Shoqatës Sportive Ylberi 1994(FC EAGLES) , për një afat kohor 1(një vit). Sipas kontratës së huapërdorjes midis Bashkisë në cilësinë e "Huadhënësit" dhe Shoqatës Sportive Ylberi 1994(FC EAGLES) në cilësinë e "Huamarrësit". Bashkëngjitur modeli tip.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurorimeve dhe Asetet dhe Qendra e Arsimit Bashkia Lushnje.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi " Tel:+355 35 22213 9 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8244 **Prot.**

Lushnje më, 20/10/**2025**

RELACION

KËSHILI IT BASHKIAK

Këtu

"PËR MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PA KUNDËRSHPËRBLIM FUSHËN SPORTIVE "LLAZAR LLUPO" KRUTJE,NJËSIA ADMINISTRATIVE KRUTJE PËR EKIPET SPORTIVE TË SHOQATËS SPORTIVE YLBERI 1994(FC EAGLES)".

Të nderuar këshilltare/këshilltarë!

Pranë Institucionit të Bashkisë Lushnje është paraqitur kërkesa e Shoqatës Sportive Ylberi 1994(FC EAGLES).e cila kërkon përdorimin e fushës sportive" Llazar Llupo" në Krutje,Njësia Administrative Krutje Bashkia Lushnje. Kjo kërkesë konsiston në faktin se Shoqata Sportive Ylberi 1994(FC EAGLES) ka ekipe sportive futbollli të moshave "nxënës parashkollor" dhe kërkon ti stërvisë jashtë orarit mësimor dhe jashtë kohës së aktiviteteve të kryer nga shkolla Krutje. Qëllimi është që të bëhët dhe aktivizimi i fëmijëve të zonës përreth duke përdorur sportin si një faktor bashkimi, edukimi i cili është edhe një element i rëndësishëm për të larguar fëmijët nga jeta virtuale e rrjeteve sociale dhe të bëjnë edhe evidentimin e talentëve të reja. Shoqata Sportive Ylberi 1994(FC EAGLES) kërkon të përdori fushën sportive pa pagesë dhe të kontribuojë për mirëmbajtjen e fushës sportive " Llazar Llupo".

Adresa:Lagjia "Kongresi " Tel:+355 35 2221 9 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Referuar nenit 25 "Funksionet e bashkive në fushën e kulturës,sportit dhe shërbimeve argëtuese" pika 4 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar. Ligji Nr. 79/2017 "Për sportin" (ndryshuar me ligjin nr. 105/2020, datë 29.7.2020), neni 5, neni 6 pika 3.

Kërkojmë miratimin për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim fushën sportive "Llazar Llupo" Krutje,Njësia Administrative Krutje Shoqatës Sportive Ylberi 1994(FC EAGLES) nga ekipet sportive, për një afat kohor1 (një) vit. Sipas kontratës së huapërdorjes midis Bashkisë në cilësinë e "Huadhënësit" dhe Shoqatës Sportive Ylberi 1994 (FC EAGLES) në cilësinë e "Huamarrësit".

Faleminderit për mirëkuptimin !

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi " Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com